



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2232 852

Nr. 2038 Prot.

Tiranë, më 12.12.2011

(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Lënda: Dërgohet "Raporti i punës për muajin Nëntor 2011"

Drejtuar: **Z. EDUARD HALIMI**
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar Z. Ministër!

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimin të dënimeve alternative", bashkëlidhur po Ju dërgojmë raportin mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Nëntor 2011.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

Konceptoi: Ersida Mulkurti 

Datë 12.12.2011





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R A P O R T
PËR MUAJIN NENTOR 2011

PËRMBAJTJA

Lënda	Faqe
I. Statistika	
-Numri i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për muajin Nentor 2011 .	(1)
- Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për secilin lloj dënimi alternativ.	(2-3)
- Numri total i të dënuarve me dënime alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (datë 30.11.2011).	(4)
- Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore	(6)
-Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.	(7)
II. Bashkëpunimi me partnerët	
-me OJF-të dhe partnerët.	(8)
-me organet e pushtetit qendror dhe pushtetin vendor	(9)
III. Problematika e punës.	
- Zyrat e reja Vendore dhe ngarkesa.	(10)

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Nentor 2011.

I. Statistika

Për periudhën 01-30 Nentor 2011, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01- 30 Nentor 2011, statistikat rezultojnë si më poshtë:

1. Numri i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për muajin Nentor 2011 .

Në muajin Nentor, nga data 01-30.11.2011, kanë ardhur pranë Zyrave Vendore 182 Urdhëra Ekzekutimi nga Prokuroria, që do të thotë se do të mbikëqyren nga Shërbimi i Provës edhe 182 të dënuar më shumë. Gjatë këtij muaji kanë përfunduar dënimin alternativ 50 të dënuar. Këto të dhëna jepen më poshtë sipas Tabelës 1.

Tabela 1. Të dënuarit shtesë në mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës për muajin Nentor 2011 (01-30.11.2011).

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	SHTOHEN	PËRFUNDUAN	TOTALI
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	145	30	115
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	2	2	0
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	13	3	10
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	22	15	7
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	0	0	0
TOTALI		182	50	132

